REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MARIA M. DANO
ADRESA Mihal Duri, Nr. 4
TEL: 694099966

# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 1086** **Nr. koleksioni: 337**

**Tirane më 21/03/2025**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A2025053190032878724

***Akti noterial përbëhet nga 4 fletë**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NR. 1086 REP.
NR. 337 KOL.

A20250531900328787 24

## KONTRATË DHURIMI
*(pasuri e luajtshme-kuota kapitali)*

Sot, më datë 31. 03. 2025 , para meje Notere MARIA M. DANO, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Mihal Duri, Nr. 4, u paraqit personalisht:

**PALA DHURUESE: Znj. Adriana Gjiknuri,** atësia Thodhori, amësia Liri, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banues në TIRANË, me adresë Mihal Duri; Nd. 20; H. 3; Ap. 32; Njësia Administrative Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 10/03/1983, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 038551759 dhe nr. personal I35310191T;

*(Pala dhuruese e ka përfituar pjesën takuese të bashkëpronësisë sipas Deshmise se Trashegimise Testamentare Nr. 816 Rep. Nr. 422/1 Kol., date 26.06.2021, te Noter Jetmira Veraj, si rrjedhim ajo është pasuri vetjake, këtu e më poshtë, për efektet e kësaj kontrate referuar si "**Dhurues**").*

**PRANUES I DHURIMIT: Z. Andi Gjiknuri,** atësia Thodhori, amësia Liri, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, me adresë Rajoni 1,L.'15 Tetori'; Nd. 176; Vlorë; lindur më 02/04/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033812595 dhe nr. personal I00402165D;

*(këtu e më poshtë, për efektet e kësaj kontrate referuar si **Pranues Dhurimi**").*

**DHËNËS PËLQIMI: Znj. Liri Gjiknuri,** atësia Hasan, amësia Salihe, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banues në VLORË, me adresë Pavarsia 04140495; Nd. 3; H. 10; Ap. 64; Vlorë; Vlorë; 9405; Vlorë, lindur më 05/01/1955, gjendja civile "e ve", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035784059 dhe nr. personal F55105153V

*(këtu e më poshtë, për efektet e kësaj kontrate referuar si "**Miratuese**").*

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 761 e vijues i tij; si edhe ligjit nr. *110/2018 "Për Noterinë"*, neni 62, pika 1, gërma "ll", si dhe nenet 99, 100, 101; si dhe Udhëzimit nr. 232, datë 14.1.2016 "Mbi ndryshimin e Pronësisë së mjeteve rrugore" e vijues bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja hartimin e Kontratës së Dhurimit Pasuri e Luajtshme – automjet, sipas kushteve dhe kritereve ligjore të mëposhtme:

## DISPOZITA PARAPRAKE:

**A. Shoqëria "Andi." shpk** është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuara, e themeluar sipas ligjeve të Republikes se Shqipërisë, me seli në adresën: Vlorë , lagjia Pavarësia, rruga Pelivan Leskaj, pallati Andi 3, kati i 2-të, e regjistruar pranë regjistrit tregtar me NUIS J66903237U, që ka si objekt kryesor të aktivitetit të saj "punime, ndërtime civile" (nga këtu e në vijim referuar si **"Shoqëria"**).

A2025053190032878724

**B.** Siç rezulton nga ekstrati i regjistrit tregtar nxjerrë nga Qëndra Kombëtare e Biznesit për të dhënat e shoqërisë, ortakë të shoqërisë janë pala dhuruese i cili zotëron 1 (një) kuote të barabartë me 25% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 56.573.541,0 lekë dhe pala pranuese i cili zotëron 1 (një) kuote të barabartë me 75% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 169.720.623,00 lekë. **Këtë të drejtë pala dhuruese e ka fituar sipas Deshmise se Trashegimise Testamentare Nr. 816 Rep. Nr. 422/1 Kol., date 26.06.2021, për rrjedhojë është pronar i vetëm i 1 (një) kuote të barabartë me 25% të kapitalit të shoqërisë "Andi.: sh.p.k.**

**C.** Pala Dhuruese i ka njoftuar Palës Pranuese të Dhurimit dëshirën e saj për të kaluar në pronësi të Palës Pranuese të Dhurimit një pjesë të kapitalit të zotëruar prej saj në kapitalin e regjistruar të shoqërisë, saktësisht 12.5% të kapitalit që zotëron dhe Pranuesi i Dhurimit ka pranuar të fitojë pronësinë mbi pjesët e kapitalit të ofruara nga Pala Dhuruese në shoqëri, sipas parashikimeve të kësaj kontrate.

**D.** Referuar Ekstratit të Regjistrit Tregtar, kushti qe, per sa kohe do te jete gjalle bashkeshortja e testamentlenesit, Znj. Liri Gjiknuri, femijet te mos bejne anje disponim apo transaksion me kuotat dhe kapitalet e shoqerise pa pelqimin e saj me shkrim.

***Atëhere, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, palët bien dakort për sa më poshtë vijon:***

## NENI 1
## OBJEKTI I KONTRATËS

**1.1** Pala Dhuruese transferon në pronësi të Palës Pranuese të Dhurimit një pjesë të kapitalit të zotëruar prej saj në kapitalin e regjistruar të shoqërisë "Andi." Sh.p.k, saktësisht 12.5% të kapitalit që zotëron dhe Pranuesi i Dhurimit pranon dhurimin e kuotave si më sipër.

**1.2** Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhurimi, pala dhuruese Znj.Adriana Gjiknuri zhvishet nga pronësia dhe zotërimi i 12.5% të kuotave që zotëron në kapitalin e shoqërisë 'Andi." Sh.p.k të cilat i kalojnë në pronësi Z.Andi Gjiknuri dhe mbetet pronar vetëm i 12.5 % të kuotave të kësaj shoqërie.

**1.3** Pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhurimi vlera e kapitalit të shoqërisë përbëhet:

**Znj. Adriana Gjiknuri,** zotëruese e kuotës/pjesës që përfaqëson 12.5 % të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 28.286.770,5 lekë

**Z. Andi Gjiknuri,** zotërues i kuotës/pjesës që përfaqëson 87.5 % të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 198.007.393,5 lekë.

**1.4** Pjesa e kuotës e zotëruar nga pala dhuruese në kapitalin e shoqërisë transferohet në favor të pranuesit të dhurimit pa kundërshpërblim, pa pengje, barra apo kufizime të asnjë lloji.

## NENI 2
## TRANSFERIMI I TË DREJTAVE MBI PJESËMARRJEN

**2.1** Pronësia mbi kuotën/pjesën e kapitalit të shoqërisë, objekt i kësaj kontrate, kalon nga pala dhuruese tek pala pranuese e dhurimit menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate. Kalimi i pronësisë së kuotave në favor të palës pranuese të dhurimit do të regjistrohet në Qëndrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin 9901/2008 'Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe Ligjin 9723/2007 "Për qëndrën kombëtare të regjistrimit ", të ndryshuar.

**2.2** Me nënshkrimin e kësaj kontrate pala dhuruese humbet çdo të drejtë lidhur me 12.5 % të kapitalit të shoqërisë, që transferohen nëpërmjet kësaj kontrate në favor të palës pranuese të dhurimit, përfshirë të drejtën e ushtrimit të votës, në mbledhjet e Asamblesë dhe ndarjes së fitimeve që rrjedhin nga zotërimi i tyre. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që sipas Ligjit burojnë nga zotërimi i 12.5% të

A2025053190032878724

kapitalit të shoqërisë të dhuruara sipas kësaj kontrate, i transferohen palës pranuese të dhurimit dhe ky i fundit bëhet titullar i vetëm dhe i ligjshëm i 12.5% të kapitalit të shoqërisë.
**2.3** Me nënshkrimin e kësaj kontrate pala pranuese e dhurimit gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësisë mbi 12.5 % të kapitalit të shoqërisë, objekt të kësaj kontrate, në emër të tij në Regjistrin Tregtar pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit.

**NENI 3**
**DEKLARIMET DHE GARANCITË E PALËS DHURUESE**

**3.1** Pala dhuruese pranon se deklarimet e mëposhtme janë të vërteta, të plota dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate:
**a.** Pala dhuruese në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate zotëron ligjërisht kuotat që do të transferohen sipas kësaj kontrate dhe ka të drejtë për ti transferuar këto kuota.
**b.** Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj kontrate nga pala dhuruese nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutinmarrëveshje apo dukumente të tjera ligjore subjekt I të cilave është pala dhuruese.

**NENI 4**
**DEKLARIMET DHE GARANCITË E PALËS PRANUESE TË DHURIMIT**

**4.1** Pala pranuese e dhurimit pranon se deklarimet e mëposhtme janë të vërteta, të plota dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate:
**a.** Pala pranuese e dhurimit ka tagra të plota për të pranuar pjesët e kapitalit nga pala dhuruese sipas përcaktimeve të kësaj kontrate..
**b.** Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj kontrate nga pala pranuese e dhurimit nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, marrëveshje apo dukumente të tjera ligjore subjekt I të cilave është pala pranuese e dhurimit.

**NENI 5**
**TË NDRYSHME**

**5.1** Kjo kontratë mund të plotësohet, ndryshohet apo modifikohet vetëm me marrëveshje reciproke midis palëve. Asnjë plotësim, modifikim apo ndryshim nuk është i detyrueshëm përveçse në rastet kur ai është me shkrim dhe i nënshkruar nga të dyja palët.
**5.2** Kjo kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit 9901/2008 'Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të çdo dispozite tjetër rregulluese sipas legjislacionit shqiptar të aplikueshëm.
**5.3** Të gjitha mosmarreveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i Kushteve të kësaj kontrate, do të zgjidhen me marrëveshje midis palëve, në rast të kundërt janë objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Kompetent.
**5.4** Çdo kosto, shpenzim apo detyrim financiar, për kalimin e pronësisë së Kuotës që dhurohet do të përballohen nga Pala që ngarkohet ligjërisht sipas legjislacionit në fuqi.
**5.5** Kjo kontratë nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me vlera të njëjta juridike;
**5.6** Bashkëlidhur me këtë kontratë dhe pjesë integrale e saj janë:

**BAZA LIGJORE**

Baza ligjore e Kontratës së Dhurimit është:

- Kodi Civil Shqiptar (Neni 761, 762, 764 e vijues i tij).
- Kodi i Familjes (Neni 73, neni 74/a, 77/b e vijues i tij).
- Ligji nr. 110/2018 "Për Noterinë".

A2025053190032878724

Bashkëlidhur, gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:

- *Vendimi i Asamblesë së Ortakëve*
- *Kopje e mjeteve të identifikimit të palëve*
- *Ekstrat i nxjerrë nga QKB*
- *Kopje e përgjigjes nga Regjistri i Barrëve Siguruese*

Kontrata e Dhurimit pasuri e luajtshme, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave Personale"*, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALA DHURUESE:**

**Znj. Adriana GJIKNURI** ____________________

**PRANUES I DHURIMIT:**

**Z. Andi GJIKNURI** ____________________

**DHËNËS PËLQIMI:**

**Znj. Liri GJIKNURI** ____________________

**NOTER / MARIA M. DANO**

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

NOTER TIRANE

QKB Qendra Kombëtare e Biznesit National Business Center

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | |
|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | J66903237U |
| 2. Data e Regjistrimit | 01/06/1993 |
| 3. Emri i Subjektit | ANDI. |
| 4. Forma ligjore | SHPK |
| 5. Data e themelimit | 04/04/1995 |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 04/04/1995 |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Vlore Vlore VLORE Lagjja Pavaresia, Rruga Pelivan Leskaj, Pallati Andi 3, Kati 2 |
| 8. Kapitali | 226.294.164,00 |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 2,00 |
| 9. Objekti i aktivitetit | Projektim, ndertime civile, industriale, ekonomike, ndertime rrugesh, kanalizime, ujesjellesa, tregtim materiale ndertimi etj.Bar-Bufe.Punime Ndertimi,montim dhe rikonstruksion I objekteve te cdo lloji. Projektim, Mbikqyrje Punimesh Ndertimi, Kolaudim Punimesh Ndertimi, Studime Urbanistike, Konsulenca Inxhinjerike, Preventiv, Tregetim, Import, Eksport Materialesh te Ndryshme, Kerkime gjeologjike, Vleresime Mjedisore dhe Punime Topografike, Punime Digjitalizimi, Studime dhe Projektime gjeologo-inxhinierike, Studime dhe projektime hidro-gjeologjike-Ndertime rrugore te kategorise se pare, te dyte, te trete dhe te katert, punime bonifikimi.-Prodhim i materialeve te ndertimit si dhe transportimi i tyre.Aktivitet ne turizem bare dhe restorant, -Ndertime hekurudhore dhe detare, .-Punime ne prodhim e shperndarje te energjise, punime sherbimi, rilevime topografike, elektrike etj.-Ndertime civile te te gjithe kategorive.-Ne fushen e projektimeve te ndertimeve civile, renda al, turistike, prodhimin e materialeve inerte, prodhim elemente renda e beton-arme-Opecione blerje dhe shitje te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme.-Shoqeria pervec sa me siper, mund te shes, te blej dhe te marre- pjese ne formen e aksioneve ose jo ne te tjera shoqeri vendase ose te huaja, te cilat kane renda te njejten veprimtari ose te ngjashme me te.-Administrimin dhe konsulence ne fushen e hotelerise, restoranteve dhe bareve, perfshire ketu edhe |

Kopje web

| | |
|---|---|
| | hapjen e tyre ne te gjithe territorin e Shqiperise.-Te marre pjese ne tendera publike ose private, kombetare dhe nderkombetare ne fushen e ndertimit, infranstrukturave, te energjise dhe ne fusha te tjera vetem ose ne bashkepunim e ortakeri te perkohshme me shoqeri te tjera.-Te marre pjese me aksione edhe ne shoqeri te tjera vendase, te huaja ose me renda te perbashket qe kane renda shoqeror dhe aktivitet te ngjashem me te.-Te krijoje renda dhe zyra perfaqesie ne qytete te tjera te Shqiperise, ose ne shtete te tjera, ne perputhje me legjislacionin e tyre.-Te kryeje cdo aktivitet tregtar, financiar, dhenie-marrje me qera, te vendose pengje dhe barre hipotekore, aktivitete keto te konsideruara rend dobishme apo te nevojme per te arritur qellimet e shoqerise dhe qe nuk tekalojne ne mase aktivitetet kryesore, te cituara me siper.-Projektim ten gjitha llojeve te veprave energjitike, ndertimi i hidrocentraleve te te gjitha llojeve dhe impjantevete ndryshme energjitike.-Menaxhimi dhe operimi i veprave te ndryshme energjitike.-Operimi optimal tekniko ekonomik i hidrocentraleve , tremocentraleve dhe llojeve te tjera te impjanteve renda , termale dhe solare per prodhimin e energjise elektrike.-Shitja e energjise elektrike klienteve dhe operatoreve te ndryshem privat apo shteterore renda dhe jashte vendit. |
| 10. Administratori/ët | Florian Mitrushi |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 05/07/2021 — Deri: 05/07/2026 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | |
| 12. Ortakët | AdrianaGjiknuri |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: — Natyre: 56.573.541,00 |
| 12.2 Numri i pjesëve | 1,00 |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 25,00 |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | |
| 13. Ortakët | AndiGjiknuri |
| 13.1 Vlera e kapitalit | Para: — Natyre: 169.720.623,00 |
| 13.2 Numri i pjesëve | 1,00 |
| 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 75,00 |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse* | |

| | |
|---|---|
| *zotëron kuotën si përfaqësues)* | |
| 14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | Tirane Tirane TIRANE Rruga "Ibrahim Rugova" , Ndertesa Nr-28, Hyrja 9, kati i pare , Njesia Bashkiake Nr.5 , Tirane Tirane Tirane Rruga " Ali Demi " Njesia Nr.1 dhe Nr. 3, Njesia Strukturore TR/116, Tirane Vlore Vlore VLORE,Iveko Fiat me targe AA925RJ Vlore Vlore VLORE Mitsubishi me targe AB139BK Vlore Himare HIMARE Potam, Objekt banimi 4 kate, parkim nentoke Vlore Vlore MERCEDES BENZ me targe AB781PS 9400Vlore Vlore VLORE Volvo me targe AB720EY Vlore Vlore VLORE, Caterpilar me targe VL1014D Vlore Vlore VLORE Mitsubishi me targe AB138BK Vlore Himare VUNO Jale, Objekt Sherbimi, Hotel 1. 2 dhe 3 kate me 2 kate nentoke Vlore Vlore MERCEDES BENZ me targe AB781PS VLORE |
| 15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: ANDI.<br>E-Mail: marjetaqose@gmail.com<br>Telefon: 0692051006 0694090383<br>Të Tjera: Depozitohet vendimi nr.1 date 23.03.2010 ku caktohet shoqeria IL-SA-AUDITING me nipt K92720402A perfaqesuar nga administratorja Eksperte Kontabel e Autorizuar Znj Valentina Haxhi (Hoxha) per vleresimin e mases se shteses se kapitalit |
| 16. Statusi: | Aktiv |

Kopje

Datë: 22/03/2025

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

FIRMA E NDERTIMIT "ANDI" Sh.p.k
NIPT J66903237U
Telefon: 00355 33 226196
E-mail : andi@andiconstruction.com
Adresa: L.Pavaresia, Rr. Pelivan Leskaj, Pallati Andi
3, Kati 2, Vlorë, Shqipëri

ANDI CONSTRUCTION

**Vendim Nr. 5** **Datë 21 /03 /2025**

**VENDIM I ASAMBLESË
SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË "ANDI." SHPK**

Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë **"ANDI." SHPK** me nr. NIPT J66903237U, e thirrur nga Administratori i saj **Z. Florian Mitrushi**, zhvilloi mbledhjen e saj sot më datë 21 / 03 /2025, ora 11:00, me rendin e ditës si vijon:

***Rendi i ditës;***

- **Dhurimin e 12.5% të kuotave/kapitalit që zotërohen nga ortaku Adriana Gjiknuri në favor të ortakut Andi Gjiknuri;**
- **Të tjera eventuale;**

Ortakët e shoqërisë të pranishëm në mbledhje janë:

1. **Znj.Adriana Gjiknuri,** zotëruese e kuotës/pjesës që përfaqëson 25 % të kapitalit të shoqërisë.
2. **Z.Andi Gjiknuri,** zotërues i kuotës/pjesës që përfaqëson 75 % të kapitalit të shoqërisë.

Pasi u mor në shqyrtim çështja e rendit të ditës, u konstatua se janë respektuar dispozitat përkatëse ligjore dhe dispozitat e statutit të shoqërisë lidhur me procedurën e thirrjes së mbledhjes së asamblesë dhe pjesëmarrjen e ortakëve dhe se kjo çështje e rendit të ditës bën pjesë në kompetencat e Asamblesë së shoqërisë, sikurse është përcaktuar në Statutin e shoqërisë si dhe në dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.
Për sa më sipër, në përfundim të diskutimeve, Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "ANDI." SHPK unanimisht,

**VENDOSI:**

- **Të miratojë transferimin nëpërmjet dhurimit të 12.5% të kuotave/kapitalit të zotëruar prej ortakut Adriana Gjiknuri në kapitalin e regjistruar të shoqërisë, në favor të ortakut Andi Gjiknuri.**

- **Ky vendim depozitohet për regjistrim pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin 9901/2008 'Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe Ligjin 9723/2007 "Për qëndrën kombëtare të regjistrimit ", të ndryshuar.**

**<u>ORTAKËT E SHOQËRISË "ANDI." SHPK</u>**

**Z. ANDI GJIKNURI**

**ZNJ. ADRIANA GJIKNURI**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER MARIA M. DANO**

V20250531900786882O4

**DATE 21/03/2025**
**NR REP 1111**

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 21/03/2025, para meje Notere MARIA M. DANO, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Mihal Duri, Nr. 4, u paraqit personalisht:/

**NËNSHKRUESIT:**

**Z. Andi Gjiknuri,** atësia Thodhori, amësia Liri, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, me adresë Rajoni 1,L.'15 Tetori'; Nd. 176; Vlorë; Vlorë; 9401; Vlorë, lindur më 02/04/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033812595 dhe nr. personal I00402165D, *në cilësinë e Ortakut të Shoqerise "ANDI"-SHPK.*

**Znj. Adriana Gjiknuri,** atësia Thodhori, amësia Liri, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banues në TIRANË, me adresë Mihal Duri; Nd. 20; H. 3; Ap. 32; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 10/03/1983, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 038551759 dhe nr. personal I35310191T, *në cilësinë e Ortakut të Shoqerise "ANDI"- SHPK.*

***Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, dokumentin: Vendim i Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "ANDI"- SHPK, bashkëlidhur këtij vërtetimi.***

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER / MARIA M. DANO**